<p>konventat ndërkombëtare apo nga marrëveshjet dypalëshe të lidhura me shtetin pritës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Emërimi dhe shkarkimi i konsujve të përgjithshëm</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Konsullata e Përgjithshme drejtohet nga Konsulli i Përgjithshëm. 2. Konsulli i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet me dekret të Presidentit, sipas propozimit të Ministrit. Konsulli i Përgjithshëm emërohet nga radhët e anëtarëve të shërbimit të jashtëm pjesë e karrierës diplomatike me të paktën gradën diplomatike këshilltar ose një gradë tjetër të barasvlershme, sipas këtij ligji. 3. Kandidati i propozuar për Konsull të Përgjithshëm duhet të plotësojë kushtet e njëjta sikur për shefa të misioneve diplomatike, të përcaktuara me këtë ligj. 4. Konsulli i përgjithshëm është në varësi të drejtpërdrejtë të Shefit të Misionit Diplomatik dhe i ushtron funksionet në përputhje me këtë ligj, si dhe në bazë të udhëzimeve të Shefit të Misionit Diplomatik, përveç nëse vendoset ndryshe nga Ministri. 5. Mandati i Konsullit të Përgjithshëm është katër (4) vjet, me mundësi vazhdimi në kohëzgjatje jo më shumë se edhe një (1) vit. 	<p>international acts and bilateral agreements concluded with the receiving state.</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Appointment and Discharge of Consuls-General</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. The Consulate General shall be led by the Consul General. 2. The Consul General shall be appointed by a decree of the President, upon proposal by the Minister. The Consul General shall be appointed among the members the Foreign Service, part of the diplomatic career system holding at least the Diplomatic Counsellor Rank or any other equal rank, in accordance with this Law. 3. The proposed candidate for Consul General shall meet the same requirements as for the Head of Diplomatic Mission, determined by this Law. 4. The Consul General shall be the direct subordinate of the Head of Diplomatic Mission and shall exercise functions in accordance with this Law, and pursuant to the instructions of the Head of Diplomatic Mission, except if decided otherwise by the Minister. 5. The mandate of the Consul General shall be 4 (four) years, with the possibility of extension for a period no longer than 1 (one) year. 	<p>aktima ili bilateralnim sporazumima sklopljenim sa državom prijema.</p> <p style="text-align: center;">Član 47 Imenovanje i razrešenje generalnih konzula</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Generalnim konzulatom upravlja generalni konzul. 2. Generalni konzul se imenuje dekretom Predsednika, predlogom ministra. Generalni konzul se imenuje iz redova članova spoljne službe koji su deo diplomatske karijere sa najmanjim zvanjem Savetnika ili drugim ekvivalentnim zvanjem, prema ovom zakonu. 3. Predloženi kandidat za generalnog konzula mora ispuniti iste uslove kao i za šefove diplomatskih misija, definisanih ovim zakonom. 4. Generalni konzul je direktno podređen šefu diplomatske misije i vrši svoje funkcije u skladu sa ovim zakonom i uputstvima šefa diplomatske misije, ako ministar ne odluči drugačije. 5. Mandat generalnog konzula je četiri (4) godine, uz mogućnost produženja u trajanju ne više od jedne (1) godine.
---	--	--

<p>6. Shkarkimi i Konsullit të Përgjithshëm bëhet sipas shkaqeve dhe procedurës së përcaktuar në këtë ligj për shefat e misioneve diplomatike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 48 Emërimi i konsujve</p> <p>1. Konsullata drejtohet nga konsulli i cili është shef i misionit konsullor ose diplomat tjetër i karrierës. Misionet tjera konsullore drejtohen nga anëtarë tjerë nga radhët e diplomatëve të karrierës që mbajnë grada diplomatike ose konsullore.</p> <p>2. Konsulli emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ministrit, në bazë të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm.</p>	<p>6. The discharge of the Consul General shall be carried out in accordance with the reasons and the procedure determined by this Law in regards to the Heads of Diplomatic Missions.</p> <p style="text-align: center;">Article 48 Appointment of Consuls</p> <p>1. The Consulate shall be led by the Consul, who shall be the Head of Consular Mission or another career diplomat. Other consular missions shall be led other members of career diplomats with diplomatic or consular ranks.</p> <p>2. The Consul shall be appointed and discharged by the decision of the Minister, based on the proposal of the General Secretary.</p>	<p>6. Razrešenje generalnog konzulata vrši se prema uzrocima i postupku utvrđenim ovim zakonom za šefove diplomatskih misija.</p> <p style="text-align: center;">Član 48 Imenovanje konzula</p> <p>1. Konzulatom rukovodi konzul koji je šef konzularne misije ili drugi diplomat karijere. Ostale konzularne misije se vode od ostalih članova karijernih diplomata koji imaju diplomatske ili konzularne činove.</p> <p>2. Konzul se imenuje i razrešava odlukom ministra, na predlog stalnog sekretara.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 49 Konsujt e nderit Emërimi, mbarimi i mandatit dhe kompetencat</p> <p>1. Konsujt e nderit emërohen nga Ministri.</p> <p>2. Konsulli i nderit është pjesë përbërëse e strukturës së shërbimit konsullor të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Kompetencat e konsullit të nderit përcaktohen me vendim të veçantë të Ministrit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 49 Honorary Consuls Appointment, Termination of Mandate and Competences</p> <p>1. The Honorary Consuls shall be appointed by the Minister.</p> <p>2. The Honorary Consul shall be an integral part of the structure of the consular service of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. The competences of the Honorary Consul shall be defined by a separate decision of the Minister.</p>	<p style="text-align: center;">Član 49 Počasni konzuli Imenovanje, prestanak mandata i nadležnosti</p> <p>1. Počasni konzuli se imenuju od ministra.</p> <p>2. Počasni konzul je sastavni deo strukture konzularne službe Republike Kosovo.</p> <p>3. Nadležnosti počasnog konzula se utvrđuju posebnom odlukom ministra.</p>

<p>4. Me rastin e emërimit të konsullit të nderit nga Ministri, duhet të merren parasysh çështjet si në vijim:</p> <p>4.1. Argumentimin e hollësishëm të nevojës së përfaqësimit të interesave të Republikës së Kosovës me konsull nderi, në rrethin konsullor të propozuar;</p> <p>4.2. Shqyrtimin e kujdesshëm të përshtatshmërisë së figurës së kandidatit për konsullin e nderit, i cili bëhet nga Agjencioni Kosovar i Inteligjencës;</p> <p>4.3. Marrjen e pëlqimit paraprak/ekzekuatorës prej shtetit pranues për emërimin e kandidatit, që shqyrtohet për konsull nderi;</p> <p>4.4. Konsulli i nderit duhet të jetë shtetas i huaj apo i Republikës së Kosovës me qëndrim të përhershëm në shtetin pranues.</p> <p>5. Konsulli i nderit merr përsipër përfaqësimin e interesave të Republikës së Kosovës, menjëherë pas dhënies së ekzekuatorës nga shteti pranues, për aq kohë sa është e nevojshme.</p> <p>6. Me vendim të Ministrit mund të kërkohet mbarimi i mandatit të konsullit të nderit, në rastin kur përfaqësimi i interesave të Republikës së Kosovës nuk konsiderohet të jetë i nevojshëm.</p>	<p>4. The proceedings for appointment of an Honorary Consul shall include:</p> <p>4.1. Detailed reasoning of the necessity of representation of the interests of the Republic of Kosovo by an Honorary Consul, in the proposed consular district;</p> <p>4.2. Careful review of the appropriateness of the background of the candidate for Honorary Consul, conducted by the Intelligence Agency of Kosovo;</p> <p>4.3. Obtaining of preliminary consent/exequatur from the receiving state about the appointment of the candidate, under review for Honorary Consul;</p> <p>4.4. Honorary consul must be foreign citizen or Kosovo citizen with permanent residence to receiving state.</p> <p>5. The Honorary Consul shall take over to represent the interests of the Republic of Kosovo, immediately after providing the exequatur from the receiving state, as long as it is necessary.</p> <p>6. By the decision of the Minister, it may be requested to terminate the mandate of the Honorary Consul, in case the representation of interests of the Republic of Kosovo is not deemed necessary.</p>	<p>4. Procedura imenovanja počasnog konzula uključuje:</p> <p>4.1. Detaljno objašnjenje potrebe zastupanja interesa Republike Kosovo sa počasnim konzulima, u predloženom konzularnom okrugu;</p> <p>4.2. Pažljivo razmatranje podobnosti imidža kandidata za počasnog konzula, koja se vrši od Obaveštajne Agencije Kosova;</p> <p>4.3. Dobijanje prethodne saglasnosti/ekzekvatore od države prijema za imenovanje kandidata, koji se razmatra za počasnog konzula;</p> <p>4.4. Počasni konzul treba da bude strani državljanin ili državljanin Republike Kosova sa stalnim boravkom u državu prijema.</p> <p>5. Počasni konzul preuzima zastupanje interesa Republike Kosovo, odmah nakon prijema ovlašćenja od strane države prijema, koliko god je to potrebno.</p> <p>6. Odlukom ministra može se tražiti prestanak mandata počasnog konzula, kada se zastupanje interesa Republike Kosovo ne smatra neophodnim.</p>
---	---	--

<p>7. Konsulli i nderit mund të kërkojë në çdo kohë të heqë dorë nga titulli i tij.</p> <p>8. Titulli konsull nderi nuk është i trashëgueshëm.</p> <p>9. Në rast të pamundësisë për të ushtruar funksionin e përfaqësimit sa më të mirë, të interesave të Republikës së Kosovës, konsulli i nderit e njofton Ministrinë nga momenti i paraqitjes së rrethanës që e pamundëson ushtrimin e këtij funksioni.</p> <p>10. Konsulli i nderit e njofton Ministrinë nëse punësohet në një shtet tjetër, përveç shtetit pranues, në një organizatë ndërkombëtare ose kur ka bërë kërkesë për një nënshtetësi tjetër.</p> <p>11. Për lejimin e fillimit të veprimtarisë së përfaqësimit të interesave të Republikës së Kosovës, konsulli i nderit pajiset nga Ministria me ekzekuatorën përkatëse, pasi të ketë paraqitur vendimin për emërimin e tij.</p> <p>Kapitulli V ANËTARËT E SHËRBMIT TË JASHTËM</p> <p>Neni 50 Kategorizimi i personelit të Shërbimit të Jashtëm</p> <p>1. Shërbimi i Jashtëm përbëhet nga:</p>	<p>7. The Honorary Consul may at any time request to waive from his title.</p> <p>8. The title of Honorary Consul shall not be inheritable.</p> <p>9. In case of inability to exercise the function of best possible representation of the interest of the Republic of Kosovo, the Honorary Consul shall notify the Ministry as soon as the circumstance disabling the exercise of such function occurs.</p> <p>10. The Honorary Consul shall notify the Ministry if he/she gets employed in another state, apart from the receiving state, in an international organization or when he/she filed an application for another citizenship.</p> <p>11. In order to allow the commencement of representation activity of the interests of the Republic of Kosovo, the Honorary Consul shall be provided with the relevant exequatur by the Ministry, after presenting the decision on his/her appointment.</p> <p>Chapter V FOREIGN SERVICE MEMBERS</p> <p>Article 50 Categorization of Foreign Service Personnel</p> <p>1. The Foreign Service shall be composed of:</p>	<p>7. Počasni konzul može u svako doba zatražiti odricanje od svoje titule.</p> <p>8. Titula počasnog konzula nije nasledna.</p> <p>9. U slučaju nemogućnosti vršenja funkcije zastupanja na najbolji način, za interese Republike Kosovo, počasni konzul obaveštava ministarstvo od trenutka nastanka okolnosti koja sprečava vršenje ove funkcije.</p> <p>10. Počasni konzul obaveštava ministarstvo ako se zaposli u drugoj zemlji, sem zemlje prijema, u međunarodnoj organizaciji ili kada podnese zahtev za drugo državljanstvo.</p> <p>11. Kako bi se omogućio početak delatnosti zastupanja interesa Republike Kosovo, počasni konzul dobija od ministarstva izdavanje odgovarajućeg ovlašćenja od strane vlade, nakon predstavljanja odluke o njegovom imenovanju.</p> <p>Glava V ČLANOVI SPOLJNE SLUŽBE</p> <p>Član 50 Kategorizacija osoblja spoljne službe</p> <p>1. Spoljna služba se sastoji od:</p>
---	--	--

<p>1.1. Diplomatët e karrierës;</p> <p>1.2. Nëpunësit civil;</p> <p>1.3. Personeli administrativ, teknik dhe i mirëmbajtjes në misionet diplomatike dhe postet konsullore.</p> <p>2. Diplomatët e karrierës janë anëtarët e shërbimit civil të cilët kanë gradë diplomatike apo konsullore. Dispozitat ligjore për nëpunësit civil zbatohen përshtatshëm ndaj diplomatëve të karrierës, përfshirë edhe rekrutimin e tyre, përveç nëse me këtë ligj dhe aktet nënligjore përkatëse përcaktohet ndryshe.</p> <p>3. Statusi dhe marrëdhënia e punës së nëpunësve me statusin e nëpunësit civil të punësuar në Ministri rregullohet sipas ligjit në fuqi për shërbimin civil dhe akteve nënligjore për shërbimin civil.</p> <p>4. Personeli administrativ, teknik dhe i mirëmbajtjes në misionet diplomatike dhe konsullore punësohet sipas ligjit të punës të shtetit pranues dhe ligjit të punës së Republikës së Kosovës. Procedurat e punësimit të personelit administrativ, teknik dhe i mirëmbajtjes rregullohen me rregulloren për shërbimin e jashtëm.</p>	<p>1.1. Career Diplomats;</p> <p>1.2. Civil Servants;</p> <p>1.3. Administrative, technical and maintenance personnel in the Diplomatic Missions and Consular Posts.</p> <p>2. Career diplomats are civil service members who hold diplomatic or consular ranks. The legal provisions on civil servants shall apply mutatis mutandis to career diplomats, including their recruitment, except if otherwise determined by this Law and relevant sub-legal acts otherwise.</p> <p>3. The status and labour relation of employees with the civil servant status employed in the Ministry shall be regulated according to the applicable Law on Civil Service and sub-legal acts on civil service.</p> <p>4. The administrative, technical and maintenance personnel in diplomatic and consular missions shall be employed according to the labour law of the receiving state and the Labour Law of the Republic of Kosovo. The employment proceedings of the administrative, technical and maintenance personnel shall be administered by the regulation on Foreign Service.</p>	<p>1.1. Diplomata od karijere;</p> <p>1.2. Civilnih službenika;</p> <p>1.3. Administrativnog, tehničkog i osoblja za održavanje u diplomatskim misijama i konzularnim pozicijama.</p> <p>2. Diplomate od karijere su članovi civilne službe koji imaju diplomatsko ili konzularno zvanje. Pravne odredbe za civilne službenike primenjivaće se u skladu sa diplomatama od karijere, uključujući njihovo zapošljavanje, sem ako ovim zakonom i podzakonskim aktima nije drugačije određeno.</p> <p>3. Status i radni odnos službenika sa statusom civilnog službenika zaposlenih u ministarstvu regulisan je važećim zakonima o civilnoj službi i podzakonskim aktima za civilnu službu.</p> <p>4. Administrativno, tehničko i osoblje za održavanje u diplomatskim i konzularnim misijama zapošljava se po zakonu o radu države prijema i zakona o radu Republike Kosovo. Procedura zapošljavanja administrativnog, tehničkog i osoblja za održavanje regulisana je propisom o spoljnoj službi.</p>
--	---	---

<p align="center">Neni 51 Personeli i misioneve diplomatike dhe konsullore</p>	<p align="center">Article 51 Diplomatic and Consular Mission Personnel</p>	<p align="center">Član 51 Osoblje diplomatskih i konzularnih misija</p>
<p>1. Personeli i misioneve diplomatike dhe konsullore përbëhet nga:</p> <p>1.1. Shefat e misioneve diplomatike;</p> <p>1.2. Diplomatët e karrierës;</p> <p>1.3. Personeli administrativ, teknik dhe i mirëmbajtjes në misionet diplomatike dhe konsullore.</p> <p>2. Në personelin e misioneve diplomatike mund të përfshihen nëpunës të emëruar nga Ministri, në bazë të një marrëveshjeje me institucionet tjera, për të kryer detyra në fushën ekonomike, juridike, kulturore, shkencore, të mbrojtjes, sigurisë dhe në çdo fushë tjetër, për një kohë të përcaktuar. Gjatë kohës së shërbimit në misionin diplomatik, këta nëpunës gëzojnë të njëjtin status me diplomatët dhe, pas përfundimit të mandatit të tyre, rikthehen në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të barasvlershëm me të. Shpenzimet për këtë kategori nëpunësish përmbushen nga institucioni dërgues.</p> <p>3. Procedurat e emërimit dhe puna e të emëruarve sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohen me marrëveshjen e shkallës së shërbimit në mes të Ministrisë dhe institucioneve tjera.</p>	<p>1. The diplomatic and consular mission personnel shall be composed of:</p> <p>1.1. Heads of diplomatic missions;</p> <p>1.2. Career diplomats;</p> <p>1.3. Administrative, technical and maintenance personnel in diplomatic and consular missions.</p> <p>2. Employees appointed by the Minister may be included in the diplomatic mission personnel, based on an agreement with other institutions to perform duties in field of economy, law, culture, science, defence, security and in any other field for certain period of time. During the period of service with the diplomatic mission, such employees shall enjoy the same status as diplomats and, after concluding their mandate, they shall return to their previous position or to a position equal to the previous position. The costs for this category of employees shall be covered by the sending institution.</p> <p>3. Procedures of appointment and obligations of appointees pursuant to paragraph 2 of this article are prescribed by a service level agreement between Ministry and other institutions.</p>	<p>1. Osoblje diplomatskih i konzularnih misija sastoji se od:</p> <p>1.1. Šefova diplomatskih misija;</p> <p>1.2. Diplomata od karijere;</p> <p>1.3. Administrativnog, tehničkog i osoblja za održavanje u diplomatskim i konzularnim misijama.</p> <p>2. Diplomatsko osoblje može uključivati službenike koje imenuje ministar na osnovu dogovora sa drugim institucijama za obavljanje poslova u privrednom, pravnom, kulturnom, naučnom, odbrambenom, bezbedonsom i u bilo kojim drugim oblastima, na određeno vreme. Tokom službe u diplomatskoj misiji, ovi zaposleni uživaju isti status kao i diplomate i nakon završetka njihovog mandata se vraćaju na svoju prethodnu poziciju ili na ekvivalentnu poziciju. Troškove za ovu kategoriju zaposlenih ispunjava institucija koja ih šalje.</p> <p>3. Procedure imenovanja i obaveze imenovanih po paragrafu 2 ovog člana se određuju sporazumom stepena službe između Ministarstva i ostalih institucija.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 52 Pranimi si diplomat i karrierës</p>	<p style="text-align: center;">Article 52 Admission as Career Diplomat</p>	<p style="text-align: center;">Član 52 Prijem kao diplomata od karijere</p>
<p>1. Si diplomat i karrierës pranohen personat të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, si dhe kërkesat e posaçme, si më poshtë:</p> <p>1.1. Të kenë të përfunduar shkollimin universitar;</p> <p>1.2. Të kenë njohuri të certifikuar të paktën të një gjuhe zyrtare të Kombeve të Bashkuara;</p> <p>1.3. Të mos jenë anëtarë të një partie politike ose të ndonjë subjekti tjetër politik;</p> <p>1.4. Të kalojnë provimin hyrës të organizuar nga Akademia Diplomatike.</p> <p>2. Vlerësimi për nevojat e pranimit si diplomat i karrierës bëhet nga Ministria, duke pasur parasysh kornizat buxhetore të Ministrisë, prioritetet strategjike dhe kahjet e politikës së jashtme.</p> <p>3. Pranimi në Shërbimin e Jashtëm si diplomat i karrierës bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, në përputhje me procedurat që zbatohen përshtatshëmrisht dhe që përcaktohen me rregullat e shërbimit civil.</p>	<p>1. The persons who meet the general requirements for employment with the civil service and the special requirements as below shall be hired as career diplomats:</p> <p>1.1. Have university qualification;</p> <p>1.2. Have certified knowledge of at least one official language of the United Nations;</p> <p>1.3. Are not members of a political party or any other political entity;</p> <p>1.4. Have passed the introductory exam organized by the Diplomatic Academy.</p> <p>2. The needs assessment for employment of career diplomats shall be performed by the Ministry, taking into consideration the budgetary framework of the Ministry, strategic priorities and orientations of foreign policy.</p> <p>3. Admission to the Foreign Service as a career diplomat shall be carried out through an open vacancy, in compliance with the procedures determined in the civil service applied appropriately.</p>	<p>1. Kao diplomata od karijere primaju se osobe koja ispunjuju opšte uslove prijema u civilnu službu, kao i posebne uslove u nastavku:</p> <p>1.1. treba imati završeno univerzitetsko obrazovanje;</p> <p>1.2. treba imati certifikovano znanje najmanje jednog službenog jezika Ujedinjenih nacija;</p> <p>1.3. ne smeju biti deo neke političke partije ili drugog političkog subjekta;</p> <p>1.4. trebaju položiti prijemni ispit, organizovan od strane Diplomatske akademije.</p> <p>2. Procena potreba za prijem diplomata od karijere se vrši od ministarstva, imajući u vidu budžetske okvire ministarstva, strateške prioritete i smer spoljne politike.</p> <p>3. Prijem u spoljnu službu kao diplomata od karijere, vrši se putem javnog konkursa, u skladu sa procedurama utvrđenim u civilnoj službi sprovedene prilagođene.</p>

<p>4. Pas përfundimit me sukses të procedurës së konkurrimit dhe përzgjedhjes, kandidati duhet të kalojë periudhën e provës në kohëzgjatje prej prej një (1) viti. Kandidati, gjatë periudhës së provës, përveç kryerjes së ciklit të detyrueshëm të trajnimit të përgatitur nga Akademia Diplomatike, trajnohet në të gjitha strukturat e Ministrisë. Pas kalimit të një viti, diplomatit të pranuar të karrierës i bëhet vlerësimi i punës nga Sekretari i Përgjithshëm.</p> <p>5. Në përfundim të periudhës së provës, kandidati i nënshtrohet provimit të organizuar nga Ministria, rezultati i të cilit përcakton pranimin ose mospranimin e tij në sistemin e karrierës diplomatike, si dhe strukturën e Shërbimit të Jashtëm ku ai punësohet.</p> <p>6. Përmbajtja dhe procedura e provimit sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor, i cili nxjerret nga Ministri.</p> <p>7. Me qëllim të zhvillimit të diplomatëve të karrierës Akademia Diplomatike zhvillon program të veçantë, i cili miratohet nga Bordi i Akademisë Diplomatike.</p>	<p>4. Following a successful conclusion of recruitment and selection procedure, the candidate shall have a probation period of one (1) year. The candidate, during the probation period, in addition to completion of compulsory training prepared by the Diplomatic Academy, shall be trained in all structures of the Ministry. After expiry of 1 (one) year, the General Secretary shall carry out the performance evaluation of the hired career diplomats.</p> <p>5. In conclusion of the probation period, the candidate shall undergo the exam organized by the Ministry, which outcome shall determine his/her acceptance or non-acceptance to the diplomatic career system and structure of the Foreign Service in which he/she is employed.</p> <p>6. The content and the procedure of the exam, under paragraph 3 and 4 of this Law, shall be determined by a sub-legal act issued by Minister.</p> <p>7. For the purpose of capacity building of career diplomats, the Diplomatic Academy shall develop a special programme approved by the Board of the Diplomatic Academy.</p>	<p>4. Nakon uspešnog završetka procedure konkurisanja i izbora, kandidat mora položiti probni period u trajanju od jedne (1) godine. Kandidat, tokom probnog perioda, pored završetka obaveznog ciklusa obuke koji priprema Diplomatska akademija, obučava se u svim strukturama ministarstva. Nakon godinu dana, primljeni službenik od karijere procenjuje se od stalnog sekretara.</p> <p>5. Na kraju probnog perioda, kandidat podleže ispitivanju koju organizuje ministarstvo, čiji ishod određuje njegov prijem ili odbijanje u sistemu diplomatske karijere, kao i strukturu spoljne službe gde se zapošljava.</p> <p>6. Sadržaj i postupak ispita prema stavu 3. i 4. ovog člana, utvrđuju se podzakonskim aktom koji se izdaje od Ministra.</p> <p>7. Diplomatska akademija razvija poseban program u cilju razvijanja diplomata od karijere koji se odobrava od Upravnog Odbora Diplomatske Akademije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 53 Zhvillimi i karrierës diplomatike</p> <p>1. Pas përfundimit të periudhës provuese dyvjeçare dhe kryerjes me sukses të provimit nga Ministria/Akademia Diplomatike sipas nenit 52, paragrafet 4 dhe 5, në Shërbimin e</p>	<p style="text-align: center;">Article 53 Diplomatic Career Development</p> <p>1. After completing a two-year probation term and successfully passing the exam for admission to the Foreign Service as a career diplomat, the candidate shall be awarded the</p>	<p style="text-align: center;">Član 53 Razvoj diplomatske karijere</p> <p>1. Nakon kompletiranja dvo-godišnjeg probacionog roka i uspešnog završetka prijemnog ispita za spoljnu službu kao diplomate od karijere, kandidat stiće status</p>

<p>Jashtëm si diplomat i karrierës, kandidati e fiton statusin e diplomatit të karrierës me gradën diplomatike Atashe.</p> <p>2. Diplomati i karrierës, i pranuar sipas konkursit, caktohet në detyrë brenda Ministrisë me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm, duke u bazuar në nevojat e Ministrisë dhe të shërbimit të jashtëm.</p> <p>3. Sistemimi i diplomatëve të karrierës të pranuar sipas konkursit bëhet sipas kriterit të grades dhe varësisht nga nevojat e Ministrisë. Procedurat dhe kriteret e sistemimit caktohen me udhëzim administrative i cili nxjerret nga Ministri.</p>	<p>status of career diplomat with the Diplomatic Rank of Attaché.</p> <p>2. A career diplomat, hired according to the vacancy, shall be assigned to his/her duties within the Ministry by a decision of the General Secretary, based on the needs of the Ministry and the Foreign Service.</p> <p>3. Placement of career diplomats admitted by advertisement is done following rank and depending on the needs of Ministry. Procedures and criteria are prescribed by administrative directions issues by Minister.</p>	<p>diplomate od karijere sa diplomatskim zvanjem ataše.</p> <p>2. Diplomata od karijere, primljen prema konkursu, određuje se na dužnost unutar ministarstva odlukom stalnog sekretara, na osnovu potrebe ministarstva i spoljne službe.</p> <p>3. Sistematizacija diplomata karijere primljenim preko konkursa se vrši po kriteriji činova i skladu sa potrebama Ministarstva. Procedure i kriteriji sistematizacije se propisuju administrativnim uputstvima izdatih od Ministra.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 54 Detyrimet e diplomatit të karrierës</p> <p>1. Diplomati i karrierës ka detyrimet e mëposhtme:</p> <p>1.1. Të mbrojnë interesat e shtetit dhe të shtetasve ose personave juridikë të Republikës së Kosovës në shtetin ose organizatën ku është akredituar dhe kryen funksionet e tij;</p> <p>1.2. Të ushtrojnë me ndershmëri dhe korrektësi funksionet dhe detyrat e ngarkuara, në përputhje me Kushtetutën, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Kosovës, këtë ligj, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore;</p>	<p style="text-align: center;">Article 54 Obligations of the Career Diplomat</p> <p>1. A career diplomat shall have the following obligations:</p> <p>1.1. Protect the interests of the state, citizens and legal persons of the Republic of Kosovo to the state or organization where he/she is accredited and exercises his/her functions;</p> <p>1.2. Exercise the assigned functions and duties with honesty and accuracy, in compliance with the Constitution, international acts compulsory for the Republic of Kosovo, this Law and other legal and sub-legal acts;</p>	<p style="text-align: center;">Član 54 Obaveze diplomata od karijere</p> <p>1. Diplomata od karijere ima sledeće obaveze:</p> <p>1.1. da štiti interese države i građana ili pravnih lica Republike Kosovo u državi ili organizaciji u kojoj je akreditovan i vrši svoje funkcije;</p> <p>1.2. da vrši na pošten način i korektno dodeljene funkcije i dužnosti, u skladu sa Ustavom, obavezujućim međunarodnim aktima za Republiku Kosovo, ovim zakonom, i drugim zakonskim i podzakonskim aktima;</p>

<p>1.3. Të mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës dhe, kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave dhe të vendimeve që zbaton, të njoftojë nivelet urdhërdhënëse dhe nivelet eprorë të këtyre të fundit;</p> <p>1.4. Të mos bëjë pjesë në asnjë parti, organizatë ose shoqatë politike dhe gjatë ushtrimit të funksionit të tij të mos reflektojë anim partiak;</p> <p>1.5. Të mbajë, në të gjitha rrethanat, një qëndrim moral të denjë dhe të paqortueshëm;</p> <p>1.6. Të mos bëjë deklarime publike që bien ndesh me politikën e jashtme të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.7. Të respektojë ligjet e shtetit ku është akredituar dhe të mos përfshihet në veprimtari të cilat mund të vlerësohen si ndërhyrje në punët e brendshme të këtij shteti;</p> <p>1.8. Të ushtrojë veprimtarinë e tij në vendin ku është akredituar, në përputhje me imunitetet dhe privilegjet që gëzon si anëtar i trupit diplomatik;</p> <p>1.9. Të mos ushtrojë në shtetin ku është akredituar veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjetër fitimprurëse për llogari të tij, familjarëve të tij ose personave të tretë;</p>	<p>1.3. Have full responsibility for the lawfulness of actions during the exercise of duty and, when he is not convinced on the legality of orders and decisions he/she implements, he shall notify the ordering institutions and superiors of the latter ones;</p> <p>1.4. Not be a member a political party, organization or association and while exercising his/her function, he/she shall not reflect any biasness on party basis;</p> <p>1.5. Maintain, under any circumstance, a moral, dignifying and irreproachable standing;</p> <p>1.6. Give no public statements that contradict with the foreign policy of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.7. Comply with the laws of the state he/she is accredited to and not get involved in any activity that may be considered as interference to internal affairs of such state;</p> <p>1.8. Exercise his/her activity to the state he/she is accredited, in compliance with the immunities and privileges enjoying as a member of the diplomatic mission;</p> <p>1.9. Not exercise to the state he/she is accredited any trade activity or any other profitable activity for his/her own account, his/her family or the third persons;</p>	<p>1.3. da snosi potpunu odgovornost o zakonitosti izvršenih dela tokom obavljanja dužnosti i, kada nije uveren o zakonitosti naloga i odluka koje sprovodi, obavesti nivo koji daje naloge i podređene nivoe istih;</p> <p>1.4. da ne bude deo bilo koje stranke, organizacije ili političkog udruženja i tokom vršenja svoje funkcije ne odražava partijsku pristrasnost;</p> <p>1.5. da drži pod svim okolnostima, dostojan i moralan i besprekoran stav;</p> <p>1.6. da ne daje javne izjave koje su u suprotnošću sa spoljnom politikom Republike Kosovo;</p> <p>1.7. da poštuje zakone države gde je akreditovan i da se ne uključe u aktivnostima koje se mogu oceniti kao uplitanje u unutrašnje poslove te države;</p> <p>1.8. da obavlja svoju delatnost u zemlji gde je akreditovan, u skladu sa imunitetima i privilegijama koje uživa kao član diplomatskog kora;</p> <p>1.9. da u državi gde je akreditovan ne vrši komercijalne ili bilo koje profitabilne delatnosti na njegov račun, račun članova porodica ili trećih lica;</p>
--	---	---

<p>1.10. Të zbatojë rregullat për informacionin e klasifikuar edhe pas largimit nga Shërbimi i Jashtëm, si dhe të sigurojë ruajtjen e të dhënave dhe të informacioneve që i janë besuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 55 Delegimi jashtë Shërbimit të Jashtëm i diplomatit të karrierës</p> <p>1. Diplomati i karrierës delegohet në pozita që mbulojnë marrëdhëniet me jashtë në institucionet shtetërore pas marrëveshjes përkatëse ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe këtyre institucioneve (si këshilltar diplomatik).</p> <p>2. Diplomati i karrierës mund të delegohet në organizatat ndërkombëtare ose mekanizmat tjera shumëpalëshe për periudha të përkohshme në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit, pas miratimit nga Ministri dhe me marrëveshje ndërmjet Ministrisë dhe diplomatit në fjalë. Kjo periudhë është vijim i pandërprerë i statusit të diplomatit të karrierës.</p> <p>3. Periudha e delegimit në detyrat e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni merret në konsideratë me qëllim të llogaritjes së afatit kohor të nevojshëm për përfitimin e gradave diplomatike.</p>	<p>1.10. Apply the rules of classified information also after leaving the Foreign Service and ensure the protection of data and information he/she has been entrusted to.</p> <p style="text-align: center;">Article 55 Sending career diplomat outside the Foreign Service</p> <p>1. A career diplomat may be sent in positions covering foreign relations in the state institutions, following a relevant agreement between the Ministry of Foreign Affairs and these institutions.</p> <p>2. A career diplomat may be delegated to or employed with international organizations or other multilateral mechanisms in a state representative capacity for temporary periods, following the approval of the Ministry and in agreement between the Ministry and the diploma tin question. Such period is an uninterrupted continuance of the status of career diplomat.</p> <p>3. The period of sending in the duties mentioned under paragraphs 1 and 2 of this Article shall be taken into consideration for the purpose of calculating the period required to obtain diplomatic ranks.</p>	<p>1.10. da primenjuje pravila za tajne informacije čak i nakon odlaska iz spoljne službe, i da obezbedi očuvanje podataka i informacija koje su mu poverene.</p> <p style="text-align: center;">Član 55 Slanje van spoljne službe diplomata od karijere</p> <p>1. Diplomata od karijere može se poslati na pozicijama koje pokrivaju spoljne odnose u državnim institucijama nakon odgovarajućeg sporazuma između Ministarstva inostranih poslova i tih institucija.</p> <p>2. Diplomata od karijere može se delegirati ili zaposliti u međunarodnim organizacijama ili drugim multilateralnim mehanizmima u svojstvu državnog predstavnika za privremeni period, uz odobrenje ministra i sporazumom između ministarstva i dotičnog diplomate. Ovaj period je neprekidno nastavljanje statusa diplomate od karijere.</p> <p>3. Period slanja u pomenutim poslovima iz stava 1. i 2. ovog člana razmatraće se kako bi se izračunao vremenski okvir potreban za dobijanje diplomatskih zvanja.</p>
---	--	---

<p>4. Me mbarimin e detyrës në institucionet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, diplomati i karrierës kthehet në Ministri, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.</p> <p>5. Procedurat e delegimit të parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni përcaktohen me rregulloren për shërbimin e jashtëm.</p>	<p>4. Upon completion of duties in the institutions mentioned under paragraphs 1 and 2 of this Article, the career diplomat shall return to the Ministry, in compliance with the relevant agreements.</p> <p>5. The sending proceedings set forth under paragraphs 1 and 2 of this Article shall be determined by regulation on foreign service.</p>	<p>4. Po prestanku funkcije u institucijama pomenutim u stavu 1. i 2. ovog člana, diplomata od karijere se vraća u ministarstvo u skladu sa relevantnim sporazumima.</p> <p>5. Procedure slanja predviđene u stavovima 1. i 2. ovog člana, utvrđuju se odredbom o spolnoj službi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 56 Rekrutimi i personelit vendor</p> <p>1. Me miratim të Sekretarit të Përgjithshëm, misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës punësojnë personel vendor për kryerjen e punëve të natyrës teknike, administrative dhe shërbyese.</p> <p>2. Personeli vendor mund të përbëhet nga shtetas të Republikës së Kosovës ose të huaj rezident në shtetin pritës.</p> <p>3. Mënyra e punësimit të personelit vendor, trajtimi financiar dhe funksionet që ata lejohen të kryejnë, përcaktohen me rregulloren për shërbimin e jashtëm.</p>	<p style="text-align: center;">Article 56 Recruitment of Local Personnel</p> <p>1. Upon approval of the General Secretary, the Diplomatic and Consular Missions of the Republic of Kosovo shall employ local personnel for exercising duties of technical, administrative and service nature.</p> <p>2. The local personnel may be comprised of citizens of the Republic of Kosovo and foreign citizens residents to receiving state.</p> <p>3. The manner of employment for local personnel, the financial treatment and functions they are allowed to perform, shall be determined by the Regulation on Foreign Service.</p>	<p style="text-align: center;">Član 56 Zapošljavanje lokalnog osoblja</p> <p>1. Odobrenjem stalnog sekretara, diplomatske i konzularne misije Republike Kosovo zapošljavaju lokalno osoblje za izvođenje radova tehničke, administrativne i uslužne prirode.</p> <p>2. Lokalno osoblje može se sastojati od građana Republike Kosova ili stranih državljana sa boravkom u državi prijema.</p> <p>3. Način zapošljavanja lokalnog osoblja, finansijski tretman i funkcije koje im se dozvoljavaju, utvrđuju se Uredbom o spolnoj službi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 57 Verifikimi i sigurisë dhe konfidencialiteti</p> <p>1. I gjithë personeli i Shërbimit të Jashtëm i nënshtrohet verifikimit të sigurisë sipas ligjeve në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 57 Security Clearance and Confidentiality</p> <p>1. The entire personnel of the Foreign Service shall undergo the security clearance according to the applicable laws.</p>	<p style="text-align: center;">Član 57 Verifikacija bezbednosti i poverljivost</p> <p>1. Celo osoblje spoljne službe podleže verifikaciji bezbednosti prema zakonima na snazi.</p>

<p>2. Me fillimin e punës në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, secili nëpunës i Shërbimit të Jashtëm ka për detyrë që të nënshkruaj një deklaratë të konfidencialitetit përmes të cilës deklarohet se gjatë tërë kohës që është i punësuar në Shërbimin e Jashtëm, si dhe për një periudhë kohore prej pesë (5) viteve pas përfundimit të punësimit në Shërbimin e Jashtëm, nuk do të deklarohet dhe nuk do të shpalojë asnjë informacion të klasifikuar lidhur me punën e tij në Shërbimin e Jashtëm apo ndonjë informacion tjetër të klasifikuar që ka të bëjë me Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk zbatohet në rast kur dhënia e informacionit është e detyrueshme sipas ligjit në fuqi.</p> <p>4. Mos nënshkrimi i deklaratës së konfidencialitetit dhe mos ruajtja e konfidencialitetit janë shkak për shkarkim nga detyra dhe për marrjen e masave të tjera disiplinore dhe ligjore.</p>	<p>2. Upon commencement of employment with the Foreign Service of the Republic of Kosovo, every employee of the Foreign Service shall obliged to sign a confidentiality statement, declaring that, during the entire period of service with the Foreign Service and for a period of 5 (five) years after the termination of employment with the Foreign Service, he/she shall not declare himself/herself and shall not disclose any classified information regarding his/her function in the Foreign Service or any other classified information related to the Foreign Service of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. The obligation to maintain confidentiality shall not apply when giving information is compulsory according to the applicable law.</p> <p>4. Failure to sign the statement of confidentiality and failure to maintain confidentiality shall be reasons for discharging from the function and undertaking other disciplinary and legal actions.</p>	<p>2. Po početku rada u spoljnoj službi Republike Kosovo, svaki službenik spoljne službe dužan je da potpiše izjavu o poverljivosti u kojoj se navodi da dok bude zaposlen u spoljnoj službi, kao i za period od pet (5) godina nakon prestanka radnog odnosa u spoljnoj službi neće otkrivati nikakvu poverljivu informaciju vezano za svoj rad u spoljnoj službi ili bilo koje druge tajne podatke koje se odnose na spoljnu službu.</p> <p>3. Obaveza održavanja poverljivosti neće se primenjivati ako je davanje informacije obavezno prema zakonu na snazi.</p> <p>4. Nepotpisivanje izjave o poverljivosti i nečuvanje poverljivosti su razlog za razrešenje od dužnosti i za preduzimanje drugih disciplinskih i zakonskih mera.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 58 Caktimi në detyrë dhe mbarimi i detyrës në misionet diplomatike dhe konsullore</p> <p>1. Diplomatët e karrierës caktohen në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës nga Ministri, pasi kanë marrë gradën e parë diplomatike “Atashe.”</p>	<p style="text-align: center;">Article 58 Assignment and Termination of Duty in Diplomatic and Consular Missions</p> <p>1. Career diplomats shall be assigned to diplomatic and consular missions of the Republic of Kosovo by the Minister, after being awarded the first diplomatic rank “Attaché.”</p>	<p style="text-align: center;">Član 58 Imenovanje na dužnost i prestanak dužnosti u diplomatskim i konzularnim misijama</p> <p>1. Diplomate od karijere se imenuju na diplomatske i konzularne misije Republike Kosovo od strane ministra nakon što dobiju prvo diplomatsko zvanje “Ataše.”</p>

<p>2. Diplomati i karrierës qëndron me shërbim në një mision diplomatik ose konsullor katër (4) vite. I njëjti mund të emërohet në misionin tjetër diplomatik ose konsullor vetëm pasi të ketë shërbyer së paku dy (2) vite në Ministri.</p> <p>3. Procedurat e caktimit dhe mbarimit të detyrës në misionet diplomatike ose konsullore përcaktohen me rregulloren për shërbimin e jashtëm.</p> <p>4. Caktimi në detyrë në misionet diplomatike dhe konsullore, bëhet në bazë të propozimit të komisionit për Rotacion, sipas një procesi të konkurrencës, bazuar në një konkurs të brendshëm.</p> <p>5. Procedura e caktimit për shërbim në misionin diplomatik rregullohet me Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.</p> <p>6. Në misione diplomatike dhe konsullore, caktohen në shërbim vetëm diplomatët që kanë gradë diplomatike dhe konsullore dhe që kanë fituar statusin e diplomatit të karrierës.</p>	<p>2. Career diplomats shall stay in service with a diplomatic or consular mission for four (4) years. The same may be appointed to another diplomatic or consular mission only after having served in Ministry for at least two (2) years.</p> <p>3. The procedures of assignment and termination of duty in diplomatic and consular missions shall be determined by the Regulation on Foreign Service.</p> <p>4. Assignment of duty in diplomatic and consular missions shall be carried out based on the proposal of the Rotation Commission, according to a process of competition, though an internal vacancy.</p> <p>5. The procedure of assignment to serve in a diplomatic mission shall be administered by the Regulation on Foreign Service.</p> <p>6. Only diplomats holding diplomatic and consular rank and who have acquired the status of career diplomats shall be assigned to serve for the diplomatic and consular missions.</p>	<p>2. Diplomate od karijere ostaju na dužnosti u diplomatskoj ili konzularnoj misiji četiri (4) godine. Isti može da se imenuje u drugoj diplomatskoj ili konzularnoj misiji samo posle službe u Ministarstvo za najmanje dve (2) godine.</p> <p>3. Postupak određivanja i završetka dužnosti u diplomatskim ili konzularnim misijama određuje se Uredbom o spoljnoj službi.</p> <p>4. Određivanje na dužnost u diplomatskim i konzularnim misijama vrši se na osnovu predloga komisije za rotaciju, u skladu sa procesom konkurencije, na osnovu unutrašnjeg konkursa.</p> <p>5. Procedura imenovanja za službu u diplomatskoj misiji reguliše se Uredbom o spoljnoj službi.</p> <p>6. U diplomatskim i konzularnim misijama određuju se da služe samo diplomate koji imaju diplomatsko zvanje i koji su stekli status diplomate od karijere.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 59 Transferimi, lëvizja paralele</p> <p>1. Transferimi dhe lëvizja paralele e diplomatit të karrierës nga një mision në tjetrin, bëhet me vendim të Ministrit, bazuar në rekomandimin e Komisionit për Rotacion.</p>	<p style="text-align: center;">Article 59 Transfer, parallel movement</p> <p>1. The transfer and parallel movement of a career diplomat from one mission to another mission shall be made by a decision of the Minister, based on the recommendation of the Rotation Commission.</p>	<p style="text-align: center;">Član 59 Transfer, paralelno kretanje</p> <p>1. Transfer i paralelno kretanje diplomate od karijere iz jedne misije u drugu vrši se odlukom ministra, na osnovu preporuke Komisije za rotaciju.</p>

